

VENDIM
Nr.424, datë 27.5.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.171, DATË 27.3.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET DHE
KRITERET E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË STACIONIT TË PLAZHIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr.93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, që i bashkëlidhet vendimit nr.171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, pas nenit 13 shtohet neni 14, me këtë përmbajtje:

“Neni 14

1. Përfshijmish, për vitin 2020, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, hapja e sezonit turistik si dhe dokumentacioni, procedura e miratimit, monitorimi për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi bëhen sipas parashikimeve të këtij neni.

2. Afati i sezonit turistik, për vitin 2020, do të jetë nga data 1 qershor deri më 15 nëntor 2020.

3. Për mbarëvajtjen dhe monitorimin e veprimtarisë së sezonit turistik ngrihet Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (KMST), që kryesohet nga ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe, në përbërje të tij, ka përfaqësues të nivelit të lartë nga:

- a) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- b) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- c) Ministria e Mbrojtjes;
- ç) Ministria e Brendshme;
- d) Ministria e Kulturës;
- dh) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Sipas rastit, Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik mund të këshillohet me përfaqësues të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, ekspertë të fushës së turizmit dhe përfaqësues të institucioneve të tjera.

4. Detyrat e Komitetit të Menaxhimit të Sezonit Turistik janë:

a) miratimi i hartës së stacioneve të plazheve si dhe plazheve publike, të cilat pajisen me një numër të veçantë identifikues, që publikohet në momentin e hapjes së aplikimit on-line, sipas listës së plazheve bashkëlidhur në shtojcën 6, të kësaj rregulloreje;

b) monitorimi i mbarëvajtjes së sezonit turistik 2020, si dhe koordinimi ndër-institucional për respektimin e masave në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

5. Si autoritet i përkohshëm për shqyrtimin e aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi ngrihet grupi teknik i shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA), i cili kryesohet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, i përbërë nga 2 (dy) anëtarë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe 2 (dy) anëtarë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

6. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Sezonit Turistik (KMST) dhe e grupit teknik të shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA) miratohet me urdhër të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

7. Përzgjedhja e subjekteve për lidhjen e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve bëhet sipas prioritetit të mëposhtëm:

a) Subjekti të disponojë një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi para strukturës akomoduese;

b) Subjekti të disponojë një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, në afërsi me stacionin e plazhit;

c) Në rast se nuk ka strukturë akomoduese apo interes nga strukturat akomoduese si më sipër, subjekti të disponojë një strukturë shërbimi me kapacitet mbi 20 tavolina dhe të ketë hapësirë plazhi para strukturës.

8. Aplikimi për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi bëhet nëpërmjet sistemit on-line e-Albania, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hapja e aplikimit, sipas njoftimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

9. Plotësimi i kërkesës së aplikimit, sipas formatit standard on-line dhe numrit identifikues përkatës të stacionit të plazhit, shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Planin e operimit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, i cili duhet të përmbajë:

i. sipërfaqen e kërkuar për përdorim (m²), brenda parcelës së përcaktuar, sipas numrit të veçantë identifikues;

ii. numrin e çadrave dhe të shezlloneve të llogaritura në përputhje me sipërfaqen e kërkuar;

iii. masat që do të ndërmerren për respektimin e kushteve e të kriterëve të higjienës.

b) Foto të strukturës akomoduese/të shërbimit, si dhe foto të qarta të hapësirës së plazhit për të cilën aplikon.

10. Grupi teknik i shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA) ndjek procedurën e mëposhtme:

a) Shqyrtimi i aplikimeve bëhet brenda 2 (dy) ditëve dhe, në rast se konstatohet mungesë dokumentacioni, grupi teknik njofton menjëherë aplikuesin për plotësimin e tyre brenda 3 (tri) ditëve;

b) Në rast subjekti plotëson kriteret sipas pikës 6, të këtij neni, dhe dokumentacioni rezulton i plotë, grupi teknik i shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA) njofton menjëherë subjektin dhe njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, për kualifikimin paraprak, me qëllim vijimin e procedurave të mëtejshme, brenda 5 (pesë) ditëve, si më poshtë vijon:

i. Negociimi ndërmjet subjektit dhe njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore mbi sipërfaqen konkrete që do t'i jepet në përdorim subjektit të kualifikuar për përdorimin si stacion plazhi;

ii. Gjenerimi i faturës nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore për kryerjen e pagesës së tarifës për sipërfaqen konkrete të negociuar më sipër;

iii. Kryerja dhe ngarkimi në sistemin on-line nga subjekti i vërtetimit të pagesës, i kryer në llogari të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me tarifën e miratuar, për sipërfaqen e negociuar si më sipër;

iv. Depozitimi i formularit të vetëdeklarimit se subjekti është njohur me kushtet, kriteret dhe kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe mban përgjegjësi të plotë për plotësimin dhe zbatimin e masave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, sipas shtojcës 7, të kësaj rregulloreje;

v. Marrëveshja me vrotues plazhi, e cila të garantojë sigurinë në stacionin e plazhit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

c) Njoftimi i subjektit nga grupi teknik i shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA) për lidhjen e kontratës së përdorimit të stacionit të plazhit, brenda 2 (dy) ditëve, me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit (AKB), duke e pajisur me certifikatën e përdorimit të stacioneve të plazhit, sipas kodit përkatës identifikues. Miratimi i modelit të certifikatës së përdorimit të stacioneve të plazhit bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

11. Stacionet e plazhit, për të cilat nuk lidhen kontrata sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje, janë plazhe publike.

12. Kontrata për dhënie në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë stacion plazhi bëhet nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, me përfitues njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse, sipas modelit tip, të përcaktuar në shtojcën 8, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, dhe kanë afat 1-vjeçar, të vlefshme vetëm për sezonin turistik 2020.

13. Për shkeljet e zbatimit të kushteve të kontratës së lidhur për përdorimin e hapësirave të plazhit, inspektorati përgjegjës për turizmin merr masat administrative deri në zgjidhjen e kontratës.

14. Njësia operationale e Task-Forcës, e ngritur me vendimin nr.15, datë 25.4.2020, të Këshillit të Ministrave, merr masat për garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë, gjatë epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

15. Për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në plazhe ngarkohet Ministria e Brendshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

16. Për sigurimin dhe zbatimin e masave parandaluese në plazhe ndaj epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, ngarkohen edhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimin nr.211, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për angazhimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për të siguruar zbatimin e masave parandaluese ndaj epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

17. Pastrimi, mirëmbajtja, pajisja me infrastrukturën mbështetëse dhe ndarja me sinjalistikën përkatëse të plazheve bëhen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

18. Përfundimisht, për vitin 2020, parashikimet e kësaj rregulloreje të zbatohen për aq sa është e mundur dhe kur nuk bien ndesh me parashikimet e këtij neni.

19. Kontratat ekzistuese të lidhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të verifikohen dhe të përshtaten me kushtet e masave të sigurisë për COVID-19 dhe parashikimet e këtij neni.

II. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, inspektorati përgjegjës për turizmin, inspektorati përgjegjës për shëndetësinë, Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (KMST), grupi teknik i shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA), njësitë e vetëqeverisjes vendore, Agjencia Kombëtare e Bregdetit si dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 2

VETËDEKLARIM

Në respektim të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, si dhe të vendimit nr. 171, datë 27.3.2019, të ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, “ ”, unë, i nënshkruari, _____ deklaroj se jam njohur me kushtet, kriteret dhe kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe mbaj përgjegjësi të plotë për plotësimin dhe zbatimin tyre, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Jam përgjegjës për, si më poshtë vijon:

- Krijimin e kushteve higjienike;
- Respektimin e hapësirave të vendosjes së çadrave sipas tipologjisë së plazhit;
- Vendosjen e sinjalistikës në stacionin e plazhit dhe kufizimin me bova të hapësirës ujore të dedikuar për not;
- Sinjalizimin e zonave të përdorimit të mjeteve lundruese për argëtim;
- Garantimin e sigurisë së jetës me vrojtues plazhi, përgjatë gjithë sezonit të ushtrimit të veprimtarisë së plazhit;

- Mirëmbajtjen e mjeteve dhe ambienteve të ndihmës së parë mjekësore;
- Afishimin e kanaleve për komunikim emergjence.
- Garantimin e protokolleve të sigurisë gjatë epidemisë Covid19, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mosplotësimi i kushteve dhe kriterëve ngarkon me përgjegjësi administrative dhe/apo, kur është rasti, me përgjegjësi penale kur sjell pasoja të rënda për shëndetin.

ADMINISTRATORI

SHTOJCA 3

KONTRATA MODEL PËR PËRDORIMIN E HAPËSIRËS SË PLAZHIT/ KONTRATË QIRAJE

Sot, më datë [•], në [•], nënshkruhet kjo kontratë qiraje (“Kontrata”) ndërmjet palëve, si më poshtë:

Agjencia Kombëtare e Bregdetit përfaqësuar nga z./znj. [•], në cilësinë e Drejtorit të Agjencisë (“Qiradhënësi”)

dhe

[•], një shoqëri [•]/person fizik, i/e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me numër unik identifikimi [•], me seli në adresën: [•], përfaqësuar nga z./znj. [•], në cilësinë e përfaqësuesit ligjor (“Qiramarrësi”).

Këtu e më poshtë, së bashku, referuar si “Palët” dhe veç e veç si “Pala”.

Njësia e qeverisjes Vendore, përfaqësuar nga, si përfitues.

MEQENËSE:

A) Qiramarrësi operon një strukturë akomoduesestruturë shërbimi të ndodhur në [•], me një kapacitet prej [•] (nëse aplikohet);

B) Mbështetur në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, qiramarrësi ka depozituar pranë qiradhënësit, në datën [•], aplikimin për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit prej [•] m², të ndodhur në [•];

C) Qiramarrësi, mbështetur në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, është njoftuar, në datën [•], për miratimin e kërkesës për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit prej [•] m² të ndodhur në [•].

Për sa më sipër dhe bazuar në nenet 801-825 të Kodit Civil, palët bien dakord, si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e hapësirës së plazhit të ndodhur në [•], me sipërfaqe prej [•] m², në administrim të qiradhënësit, sipas hartës bashkëngjitur, si shtojca 1 e kontratës.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në përdorim e hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar.

Neni 3
Kohëzgjatja

1. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë prej 1 viti, për sezonin turistik 2020, për periudhën _____ qershor -15 nëntor dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

2. Palët bien dakord që kontrata do të përfundojë me përfundimin e afatit dhe nuk do të rinovohet.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

1. Qiradhënësi dorëzon, brenda [•] ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, hapësirën e plazhit të përcaktuar në pikën 1, të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të hapësirës së plazhit që jepet me qira, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

2. Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e qiramarrësit.

3. Qiradhënësi është i detyruar të garantojë qiramarrësin për gëzimin e qetë të hapësirës së plazhit, objekt të kontratës gjatë gjithë periudhës së qirasë. Ai garanton qiramarrësin nga çdo pretendim apo të drejta nga palë të tjera në përdorimin e qetë të hapësirës së plazhit, objekt qiraje.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

1. Qiramarrësi ka të drejtë të përdorë e të gëzojë pronën e marrë në qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

2. Qiramarrësi detyrohet që:

2.1 të përdorë hapësirën e plazhit, objekt të kësaj kontrate, vetëm për qëllimin e parashikuar në nenin 2;

2.2 të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me planin e operimit të paraqitur në momentin e aplikimit për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit;

2.3 të plotësojë e të respektojë kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë të përcaktuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’ ”, të ndryshuar dhe rregullat e miratuara nga ministria përgjegjëse e shëndetësisë për shkak të epidemisë të shkaktuar nga COVID-19.

3. Qiramarrësi detyrohet të bashkëpunojë me çdo autoritet publik përgjegjës për monitorimin dhe inspektimin e plazhit e të veprimtarive turistike, si dhe t'u japë atyre akses në të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve ligjore përkatëse.

4. Qiramarrësi detyrohet të paraqesë te qiradhënësi çdo dokumentacion të nevojshëm për përmbushjen e kriterëve dhe standardeve minimale për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit.

5. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me nënqira hapësirën e plazhit të marrë me qira sipas kontratës.

6. Qiramarrësi detyrohet të ketë të punësuar vrojtues plazhi përgjatë gjithë sezonit të ushtrimit të veprimtarisë së plazhit.

7. Qiramarrësi detyrohet të afishojë certifikatën e përdoruesit të hapësirës së plazhit, certifikatën e kualifikimit të vrojtuesit të plazhit ose kopja e saj, së bashku me NIPT-in dhe lejet që ai disponon.

Neni 7

Penalitetet

1. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’ ”, të ndryshuar dhe rregullat e miratuara nga ministria përgjegjëse e shëndetësisë për shkak të epidemisë të shkaktuar nga COVID-19.

2. Në rast se konstatohet që masat për përmbushjen e detyrimeve nuk realizohen nga qiramarrësi, qiradhënësi ka të drejtë të zgjidhë menjëherë kontratën për mospërmbushje të detyrimit kontraktor.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

1. Kontrata zgjidhet me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 3.1, të kontratës.

2. Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore, aq sa nuk mund të ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit;

c) kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër sipas kontratës dhe kriteret e standardet e parashikuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’ ”, të ndryshuar si dhe rregullat e miratuara nga ministria përgjegjëse e shëndetësisë për shkak të epidemisë të shkaktuar nga COVID-19.

Në rastet e lartpërmendura, kontrata do të zgjidhet me përfundimin e afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e dërgimit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës.

3. Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit me shkrim të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara.

4. Me përfundimin e kontratës, qiramarrësi duhet të kthejë hapësirën e plazhit në të njëjtën gjendje që e ka marrë në dorëzim; në të kundërt, detyrohet të kryejë të gjitha rregullimet me shpenzimet e veta ose të paguajë vlerën përkatëse të shpenzimeve të përcaktuara me një ekspert të emëruar me marrëveshje dypalëshe.

5. Me përfundimin e kontratës, qiramarrësi ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga hapësira e plazhit, por pa dëmtuar atë. Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve të kryera nga qiramarrësi.

Neni 9
Dispozitat e fundit

1. Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil dhe vendimit nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’ ”, të ndryshuar si dhe rregullave të miratuara nga ministria përgjegjëse e shendetësisë për shkak të epidemisë të shkaktuar nga COVID-19.

2. Kontrata përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve lidhur me objektin e saj dhe ka epërsi mbi çdo marrëveshje të mëparshme me gojë apo me shkrim midis palëve.

3. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve lidhur me kontratën apo ndonjë marrëveshje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e kontratës, do të zgjidhet nga palët me mirëkuptim; në të kundërt, zgjidhja e mosmarrëveshjes do të jetë në kompetencën e gjykatës administrative përkatëse.

4. Kontrata është hartuar në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë secila.

Nr. Rendor	Nr. Koordinate	Plazhi	X (Krgjsh)	Y(krgjsh)
1	1	Plazhi i Velipojës	450136	4635540
2	2	Plazhi i Velipojës	454054	4636090
3	1	Plazhi i Shëngjinit	466028	4630828
4	2	Plazhi i Shëngjinit	466584	4625938
5	1	Plazhi i Tales	465168	4620710
6	2	Plazhi i Tales	464859	4616455
7	1	Plazhi i Gjirit të Lalzit	458683	4600730
8	2	Plazhi i Gjirit të Lalzit	459283	4596159
9	1	Plazhi Rrushkull	457814	4592308
10	2	Plazhi Rrushkull	455594	4589772
11	1	Plazhi Hamallaj	459281	4596141
12	2	Plazhi Hamallaj	457831	4592328
13	1	Plazhi i Katundit të Ri	453968	4588346
14	2	Plazhi i Katundit të Ri	452646	4586006
15	1	Plazhi Currila 4	451833	4576635
16	2	Plazhi Currila 4	451959	4576592
17	1	Plazhi Currila 5	452237	4576425
18	2	Plazhi Currila 5	452837	4575208
19	1	Plazhi i Durrësit	455597	4575634
20	2	Plazhi i Durrësit	458843	4572390
21	1	Plazhi i Rrashbullit	458856	4572366
22	2	Plazhi i Rrashbullit	459683	4569729
23	1	Plazhi Golem	459088	4566252
24	2	Plazhi Golem	459687	4569719
25	1	Plazhi Qerret	459081	4566230
26	2	Plazhi Qerret	458231	4564610
27	1	Plazhi i Gjeneralit	453676	4555127
28	2	Plazhi i Gjeneralit	453693	4554798
29	1	Plazhi i Spillesë	454373	4552372
30	2	Plazhi i Spillesë	454059	4547375
31	1	Plazhi i Divjakës	455760	4537880
32	2	Plazhi i Divjakës	454597	4535385
33	1	Plazhi Seman 1	447274	4517041
34	2	Plazhi Seman 1	446834	4514117
35	1	Plazhi Pishë Pore	446317	4509320
36	2	Plazhi Pishë Pore	444180	4505523
37	1	Plazhi i Vjetër	453763	4481746
38	2	Plazhi i Vjetër	455959	4479896
39	1	Plazhi Uji i Ftohtë-Jonufër	456904	4477298
40	2	Plazhi Uji i Ftohtë-Jonufër	455992	4475765
41	1	Plazhi Radhimë	455974	4475731

42	2	Plazhi Radhimë	455589	4467636
43	1	Plazhi Orikum 1	454971	4467536
44	2	Plazhi Orikum 1	454525	4466669
45	1	Plazhi Orikum 2	454548	4466619
46	2	Plazhi Orikum 2	453361	4465820
47	1	Plazhi Dhërmi 1	465969	4447287
48	2	Plazhi Dhërmi 1	468385	4445641
49	1	Plazhi Dhërmi 1	468651	4445607
50	2	Plazhi Dhërmi 1	469980	4444557
51	1	Plazhi Jalë	474463	4442967
52	2	Plazhi Jalë	474548	4442674
53	1	Plazhi Livadh	476060	4441762
54	2	Plazhi Livadh	477023	4441035
55	1	Plazhi Himarë 1	477966	4440777
56	2	Plazhi Himarë 1	478464	4440652
57	1	Plazhi Himarë 1	478539	4440621
58	2	Plazhi Himarë 1	478670	4440507
59	1	Plazhi Potam	478775	4440519
60	2	Plazhi Potam	479022	4439604
61	1	Plazhi Lllaman	480041	4438523
62	2	Plazhi Lllaman	480183	4438417
63	1	Plazhi i Qeparoit 1	484003	4435242
64	2	Plazhi i Qeparoit 1	484494	4435347
65	1	Plazhi i Qeparoit 2	484544	4435365
66	2	Plazhi i Qeparoit 2	485688	4435263
67	1	Plazhi i Borshit	486001	4435259
68	2	Plazhi i Borshit	489344	4432250
69	1	Plazhi i Bunecit	490554	4430322
70	2	Plazhi i Bunecit	490886	4429611
71	1	Plazhi Lukovë 1	491678	4428130
72	2	Plazhi Lukovë 1	491752	4427682
73	1	Plazhi Lukovë 1	492488	4426917
74	2	Plazhi Lukovë 1	492557	4426712
75	1	Plazhi Lukovë 1	492578	4426652
76	2	Plazhi Lukovë 1	492600	4426220
77	1	Plazhi Kakome	494756	4421532
78	2	Plazhi Kakome	494622	4421264
79	1	Plazhi Sarandë 1	499212	4415270
80	2	Plazhi Sarandë 1	500239	4415030
81	1	Plazhi Sarandë 1	500245	4415338
82	2	Plazhi Sarandë 1	500606	4415479
83	1	Plazhi Sarandë 1	500789	4415503
84	2	Plazhi Sarandë 1	501173	4415276
85	1	Plazhi Sarandë 1	501175	4415269
86	2	Plazhi Sarandë 1	501287	4414798
87	1	Plazhi Sarandë 1	501282	4414795
88	2	Plazhi Sarandë 1	501364	4414487
89	1	Plazhi Sarandë 1	501358	4414480
90	2	Plazhi Sarandë 1	501507	4414232
91	1	Plazhi Sarandë 1	501482	4414217
92	2	Plazhi Sarandë 1	501729	4412866
93	1	Plazhi Sarandë 1	501731	4412841
94	2	Plazhi Sarandë 1	500821	4410966
95		Pasqyrat (Ksamil)	500439	4407770
96		Pulëbardhat (Ksamil)	500127	4407411
97		Gjiri i Hartës (Ksamil)	500176	4406539
98		Gjiri i Baxhos (Ksamil 1)	500646	4405020
99		Plazhi (Ksamil 2)	500151	4404498
100		Gjiri Poda (Ksamil 3)	500183	4404286
101		Plazhi i Guvave (Ksamil 4)	499905	4404315
102		Plazhi 4 Ishujt (Ksamil 5)	499749	4404346
103		Plazhi Gjiri Bora-Bora (Ksamil 6)	499888	4404119

104		Plazhi i Ksamilit (Ksamil 7)	499871	4403756
105		Gjiri i Varkave (Ksamil 8)	499617	4403523
106		Plazhi i Palases	465667	4447436
107		Plazhi i Rrugeve te Bardha	464605	4448401
108		Plazhi i Pogradecit	555885	4529923
109		Plazhi i Nartes	451539	4484445
110	2	Plazhi Lungomare	457003	4479293
111	1	Plazhi Lungomare	456908	4477305
112	1	Shëngjini i sipërm	462967	4632237
113	2	Shëngjini i sipërm	464161	4631197
115	2	Plazhi Sarandë 1	498299	4415654
114	1	Plazhi Sarandë 1	497713	4415934
117		Plazhi Manastiri 2	500569	4407992
116		Plazhi Manastiri 1	500902	4408784
118		Gjiri i Varkave (Ksamil 9)	499248	4403755